



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 05.11.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNT"ALFA -i" për aktivitetin: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-2602-511 nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "**NNT ALFA -i**" e datës 02.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me Nr.616 18 2602 511 Nr. Brendshëm 616 18 026 511 kundër *Vendimit për dhënje të kontratës* të AK -së, të datës 29.10.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin e prokurimit sipas vendimit për dhënje të kontratës .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas vendimit të dates 29.10.2018.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**NNT ALFA -i**" me datë 02.11.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me numër të prokurimit 616 18 2602 511 dhe numër të brendshëm 616 18 026 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 05.11.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet për tenderuesin "NNT Alfa-i":

- 1.Pretendimi për pervojën e menaxherit të projektit është i pabazuar pasi që në CV-ne e tij është paraqitur edhe eksperiencia në ekzekutim të projekteve.

2.Pretendimi tjetër poashtu është i pabazuar pasi që nga AK-es është kërkuar një inxhinier apo bachelor i bujqësisë dhe nuk është kërkuar ndonjë drejtim i caktuar i fakultetit të bujqësisë .

3. Lidhur me pretendimin vijues sqarohet se AK-es ka kërkuar vetëm një inxhinier të elektros ndërsa OE-ik "Rexha Shpk" ka ofruar dëshmi për dy inxhinier dhe nuk është paraqitur nevojë që të bëhet ndonjë verifikim detaj lidhur me përvojën e tyre.

4.Për pretendimin e katërt sqarohet se certifikata fitosanitare për fidanet shkruan në mënyrë të qartë se është certifikate e brendshme që do të thotë se fidanet janë me origjinë vendore.

5.Lidhur me këtë pretendim ju sqarohet se komisioni i rivlerësimit ka vizituar shtetin e OE-ik dhe ka konstatuar se ai posedon të gjitha pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit .

Bazuar në konstatimet paraqitura u vendos si në dispozitiv .

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

---

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit